



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16- 8802/2012
Kaçanik, 30.04.2012

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-266 -Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të nenit 5(b) dhe 14 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.04.2012, mori këtë:

VENDIM
PËR RIEMËRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

I.

Me këtë Vendim, bëhet Riemërimi i pasurisë së paluajtshme të pronës komunale në të gjitha Institucionet: Arsimore, Shendetësore dhe të ish Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit, që në librat kadastral janë evidentuar si Pasuri shoqërore, tani Riemërohen si Pronë Komunale e Kuvendit të Komunës Kaçanik.

II.

Me këtë Vendim, obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, t'i ndërmerr veprimet e nevojshme për ndryshimet kadastrale në RDPP.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohet:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, (nëpërmjet kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante), dhe
3. Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi
